



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KLOS  
KËSHILLI BASHKISË KLOS

Nr./755 Prot

Klos, më 08.07/2021

VENDIM  
Nr: 30 datë 30/06/2021

**“PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM 2022– 2024, FAZA E PARË”**

Këshilli i Bashkisë Klos në mbledhjen e tij të datës 30/06/2021, mbështetur në ligjin 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 54, shkronja “dh”, në ligjin 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në udhëzimin nr.2, datë 06.02.2012, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, ligjin nr.68/2017 për “Financat e Vetqeverisjes Vendore”, udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.6/1, datë 28.02.2018 për përgatitjen e buxhetit vendor, udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.7, datë 26.02.2021, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesem 2022-2024”, shkresën nr.5239 prot, datë 18.03.2021, në lidhje me sqarimin mbi transfertën e pakushtëzuar sektoriale për arsimin parashkollor për Programin Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”, vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.19, datë 02.04.2021 “Për planifikimin e të ardhurave për vitet 2022-2024”, vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.20, datë 02.04.2021 “Për miratimin e tavanëve të PBA 2022-2024”, Këshilli i Bashkisë Klos mori në shqyrtim P/Vendimin e paraqitur nga Drejtoria e Burimeve Njerzore, Çeshtjeve Juridikedhe Shërbimeve Finaciare, diskutoj rreth tij dhe në përfundim me 11 (njembëdhjetë) vota pro.

**VENDOSI:**

1. Miratimin e PBA-së 2022 -2024, faza e parë, ku të ardhurat dhe shpenzimet për vitet 2022-2024 paraqiten si më poshtë vijon:

A. Të Ardhurat

Përshkrimi	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
Të Ardhurat e Planifikuara	53,910,000	57,850,000	58,120,000
Transferta e Pakushtëzuar	140,406,000	147,321,000	157,083,000
Transferta Sektoriale	67,101,932	67,101,932	67,101,932
Transferta Specifike për Mbrojtjen Civile	2,375,287	2,375,287	2,375,287
Transferta e Kushtëzuar	350,267,091	354,293,036	324,304,944

Shuma Lekë	614,060,310	628,941,255	608,985,163
------------	-------------	-------------	-------------

**B - Shpenzimet**

Përshkrimi	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
Pagat	160,137,816	160,237,816	160,437,816
Shpenzimet Operative	386,501,810	380,537,106	383,012,106
Investimet	67,420,684	88,166,333	65,535,241
Shuma Lekë	614,060,310	628,941,255	608,985,163

Bashkëngjitur tabela me tavanet përfundimtare sipas programeve që do të përdoren sipas ligjit nr.68/2017.

- Vendimi hynë në fuqi 10 ditë pas shpalljes ,pasi të shprehet dhe Prefekti i Qarkut Dibër për bazueshmërinë ligjore.
- Ngarkohet për zbatimin e vendimit Drejtoria e Burimeve Njerzore, Çeshtjeve Juridike dhe Shërbimeve Finaciare.
- U shpallë sot me date 08.042021

**SEKRETARI I KËSHILLIT  
SPARTAK VOKRRI**



**KRYETARI I KËSHILLIT  
VALBONA KOLA**



Nr. 1755 / Prot-  
Dt. 14.07.2021.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**PREFEKTI I QARKUT DIBËR**

Nr.667/1 prot.

Peshkopi, më 12.07.2021

Lenda : Mbi verifikimin e ligjshmerisë të vendimit nr. 30 date 30.06.2021

Drejtuar: BASHKISË KLOS

**KLOS**

Në mbështetje të ligjit nr.107, date 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e këshillit të bashkisë Klos, Nr 30, datë 30.06.2021, "Për miratimin e programit buxhetor afatmesem 2022-2024, faza e pare", ardhur prane nesh me date 12.07.2021 e regjistruar me Nr. 667 Prot, vendosa miratimin në parim të kësaj vendimarrje, në kushtet e respektimit te legjislacionit përkatës që është përgjegjësi direkte e stukturave të posaçme të bashkisë.

**PREFEKTI**  
**- Nexhbedin SHEHU -**

